


AKTIVIZIMI I BURIMEVE TË RRITJES EKONOMIKE

Rrugëtimi ekonomik i Kosovës: qeverisja, investimet dhe rritja e qëndrueshme



AKTIVIZIMI I BURIMEVE TË RRIJES EKONOMIKE

Rrugëtimi ekonomik i Kosovës: qeverisja, investimet dhe rritja e qëndrueshme

PËRGATITUR NGA:

Alban Hashani – drejtor ekzekutiv, Instituti Riinvest
Muhamet Mustafa – bashkëpunëtor i lartë, Instituti Riinvest

BOTUAR NGA:

INSTITUTI RIINVEST
Andrea Gropa Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320;
www.riinvestinstitute.org

Organizimi i konferencës së 30 vjetorit është sponsorizuar nga:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE



Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E drejta autoriale © 2025 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa e cituar burimin.

Përmbajtja

1. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. TRENDET E RITJES EKONOMIKE DHE TABLLOJA MAKROEKONOMIKE.....	9
2.1. Konteksti global dhe rajonal.....	9
2.2. Sfidat e trendeve të rritjes	10
2.3. Tregtia e jashtme dhe sektori i jashtëm.....	12
2.4. Sektori financiar	14
2.5. Sektori qeveritar dhe politikat e buxhetit.....	15
2.6. Borxhi publik.....	16
3. INVESTIMET - DINAMIKA, STRUKTURA DHE EFIKASITETI	17
3.1. Eficienca e investimeve dhe rritja ekonomike.....	18
4. KAPITALI NJERËZOR DHE MIGRIMI.....	22
4.1. Dinamikat në tregun e punës në Kosovë.....	24
4.2. Trendet demografike dhe pasojat e tyre ekonomike.....	26
5. MODELI I RI I RITJES EKONOMIKE PËR TË ADRESUAR KURTHIN E TË ARDHURAVE TË MESME.....	26
6. INSTITUCIONET DHE QEVERISJA EKONOMIKE.....	30
7. REFERENCAT	33
8. ANEKSET	35

Lista e Shkurtesave

ALMM	Masat Aktiv të Tregut të Punës
ANZH	Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP	Ballkani Perëndimor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ERA	Hapësirën Evropiane të Kërkimeve
FBKF	Formimi te Bruto Kapitalit Fiks
FMN	Fondit Monetar Ndërkombëtar
IJD	Investimeve e Jashtme Direkte
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
NACE	Nomenklatura për klasifikimin e sektorëve në BE
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PIP	Programi i Investimeve Publike
S3	Strategjisë për Specializimin e Mençur
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UNMIK	Administrata e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
wiiw	Instituti për Studime Ekonomike Ndërkombëtare
ZKA	Zyra Kombëtare të Auditimit

1. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rruga e zhvillimit dhe rritjes ekonomike të Kosovës është karakterizuar nga pengesa specifike afatgjata. Deri në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar, ashtu si në periudhën e sundimit të Jugosllavisë së parë, Kosova nuk përjetoi ndonjë transformim ekonomik, veçanërisht në aspektin e industrializimit dhe zhvillimit të infrastrukturës.¹ Ndërmjet viteve 1960 dhe 1988, veçanërisht pas reformave ekonomike dhe kushtetuese në Jugosllavi (1968-1974), Kosova konsolidoi autonominë e saj të gjerë territoriale dhe politike, duke përjetuar një rritje të qëndrueshme ekonomike. Kjo u reflektua në zhvillimin e infrastrukturës së saj fizike dhe sociale, në industrializimin e saj dhe në përmirësimin e strukturës së përgjithshme sociale. Megjithatë, në kohën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, PBB-ja për kokë banori e Kosovës ishte më pak se një e treta e mesatares së federatës² Që nga fillimi i viteve 1990, pavarësia e saj institucionale autonome u shkatërrua dhunshëm nën regjimin e Millosheviqit. Kjo periudhë u karakterizua nga dezinvestimi masiv, deindustrializim i rëndë, përgjysmim i prodhimit kombëtar dhe me pasoja shkatërruese të luftës (Instituti Riinvest 1998, 2000, 2014).³

Administrata e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe KFOR-i luajtën një rol vendimtar në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në Kosovë. Brenda pesë viteve, mbështetja e konsiderueshme financiare dhe teknike ndërkombëtare mundësoi zhvillimin e suksesshëm të infrastrukturës bazë fizike, shërbimeve sociale dhe strehimit. Ky përparim u mbështet më tej nga asistencë teknike efektive e përqendruar në ndërtimin e kapaciteteve, reformat ekonomike të orien-

tuara drejt tregut dhe zhvillimit institucional. Legjislacioni u hartua në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe standardet e BE-së, duke siguruar përafrimin e Kosovës me këto kritere kryesore.

Megjithatë, ky përparim nuk u shpreh në mënyrë të barabartë në një trajektore të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe as nuk arriti standardet e nevojshme në cilësinë e arsimit dhe shërbimeve shëndetësore. Me kalimin e kohës, institucionet e Kosovës zgjeruan gradualisht kompetencat e tyre, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 dhe marrjes së plotë të autoritetit, veçanërisht në çështjet ekonomike, në vitin 2011. Pavarësisht këtyre përparimeve, përmirësimet e pritura në rritjen ekonomike dhe zhvillimin shoqëror nuk u realizuan plotësisht. Politikat ekonomike, veçanërisht ato të tatimeve, nuk ishin të favorshme për investimet në sektorin privat apo për tërheqjen e investimeve të jashtme direkte (IJD). Deri në vitin 2016, tarifat doganore dhe TVSH-ja (së bashku që arrinin në 26 përqind) mbledheshin në kufi për mallrat kapitale dhe materialet e tjera hyrëse për prodhim dhe shërbime. Kjo politikë, e kombinuar me normat e larta të interesit, kontributin modest nga procesi i privatizimit me të ardhura të ngjira (rreth 0.6 miliardë euro), ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike dhe investimet e pamjaftueshme në kapacitetet e reja të prodhimit të energjisë elektrike, krijuan një mjedis biznesi të pafavorshëm për investime.

1 Gjatë asaj periudhe, në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, rindërtimi dhe investimet pas Luftës së Dytë Botërore u mbështetën pothuajse tërësisht nga grantet buxhetore. Në anën tjetër, investimet e Kosovës në infrastrukturë, industri dhe sektorë të tjerë ekonomikë u vonuan dhe u mbështetën pothuajse tërësisht në kreditë e bankave vendase, kreditë e bankave ndërkombëtare, kreditë e Bankës Botërore dhe fondin federal për mbështetje kreditore për republikat dhe provincat autonome më pak të zhvilluara (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi). Në rastin e Kosovës, kjo mbështetje çoi në një akumulim të konsiderueshëm të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, i cili ndikoi negativisht në normat e rritjes, veçanërisht gjatë viteve 1980 (Mustafa, 1985; Instituti Riinvest, 1998).

2 Prodhimi kryesor industrial i Kosovës, veçanërisht në energji dhe metale bazë, ishte i kufizuar nga kuotat e eksportit dhe ishte i detyruar të shiste produktet e tij në tregun jugosllav me çmime të kontrolluara dhe më të ulëta krahasuar me çmimet e tregut botëror. Kjo ndikoi ndjeshëm në aftësinë e kompanive për të investuar dhe për të shlyer borxhet (Instituti Riinvest, 1998).

3 Pasojat e luftës dhe administrimi i Kosovës nga Qeveria e Serbisë gjatë viteve 1990 vlerësohet se kanë shkaktuar humbje që arrijnë rreth 22 miliardë dollarë (Instituti Riinvest, 1998, 1999, 2000, 2006).

Këto sfida u përkeqësuan më tej nga mangësitë në zbatimin e kuadrit ligjor, duke përfshirë sundimin e dobët të ligjit, mosefikasitetin e sistemit gjyqësor, zbatimin e dobët të kontratave dhe masat e pamjaftueshme për luftimin e korrupsionit. Për më tepër, qeverisja ekonomike dhe cilësia e institucioneve u dobësuan nga konfliktet e ashpra politike, të cilat penguan arritjen e një konsensusi për prioritetet kryesore kombëtare dhe zbatimin efektiv të politikave të bazuara në evidencë proefionale e shkencore

Pavarësisht të gjitha këtyre sfidave, Kosova ka arritur të avancojë në statusin e një vendi me të ardhura të larta të mesme (HMIC), e nxitur nga një rritje e qëndrueshme ekonomike me mesatare prej 3 deri në 4 përqind gjatë dy dekadave e gjysmë të fundit. Megjithatë, ajo vazhdon të mbetet prapa, duke qëndruar në rreth 65 deri në 70 përqind të mesatares së gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) në terma të PBB-së për kokë banori. Vendi vazhdon të përballet me vështirësi serioze në arritjen e rritjes së nevojshme ekonomike dhe ndërtimin e kapaciteteve konkurruese për të adresuar shpërpjesëtimet kronike ekonomike, sidomos deficitin e lartë tregtar, papunësinë dhe emigracionin. Këto mbeten pengesa të rëndësishme për të arritur me sukses konvergjencën me Bashkimin Evropian (BE) dhe për të arritur nivelin e zhvillimit të vendeve me të ardhura të larta.

Ky dokument është përgatitur për të lehtësuar diskutimet në edicionin e pestë të Konferencës Ndërkombëtare të Riinvestit, me temë “Aktivizimi i Burimeve të Rritjes Ekonomike,” e organizuar për të shënuar 30-vjetorin e Institutit Riinvest. Ai mbështetet në të dhëna nga hulumtimet e Riinvestit, si dhe në publikime të Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe në diskutimet e fundit mbi politikat industriale dhe kurthin e të ardhurave të mesme. Me këtë rast falënderojmë stafin e Riinvestit për kontributin e tyre në hartimin e raporteve dhe studimeve dhe për pjesën statistikore të përfshirë në këtë raport. Falënderojmë gjithashtu edhe partnerët tanë për mbështetjen e punës sonë kërkimore.

Përfundimi ynë përmbledhës në këtë punim për edhe nga aktiviteti i tërësishëm kërkimor shtron nevojën kritike për përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe rritjen e ambicieve për përsheptimin e rritjes ekonomike. Kjo kërkon një ndryshim drejt një modeli transformues të rritjes ekonomike, me politika të hartuara për të kapërcyer kurthin e të ardhurave të mesme dhe për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe cilësore.

2. TRENDET E RRITJES EKONOMIKE DHE TABLLOJA MAKROEKONOMIKE

2.1 Konteksti global dhe rajonal

Projeksionet më të fundit të FMN-së tregojnë se rritja globale do të arrijë në 2.8 përqind këtë vit dhe 3 përqind vitin e ardhshëm, që përfaqëson një ulje kumulative prej rreth 0.8 pikë përqindje në krahasim me parashikimet e janarit. Në mënyrë të ngjashme, Anketa Globale e McKinsey-it evidenton se drejtuesit kryesorë të kompanive më të mëdha në botë po shfaqin një kujdes të shtuar, duke identifikuar paqëndrueshmërinë gjeopolitike si rrezikun kryesor, krahas faktit që më shumë se gjysma e popullsisë globale do të votojë në zgjedhjet lokale këtë vit dhe vitin e ardhshëm (McKinsey and Company, 2024). Kjo situatë padyshim do të ketë ndikim edhe në Ballkanin Perëndimor (WB6). Sipas projeksioneve më të fundit të FMN-së, pritshmëritë për rritje ekonomike janë rishikuar duke u ulur për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë (Tabela 1).

Në raportin e Bankës Botërore mbi trendet dhe parashikimet për Euroazinë Qendrore (Banka Botërore, 2024), projeksionet për rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor për vitet 2024 dhe 2025 janë vlerësuar në, respektivisht, 3.3 përqind dhe 3.5 përqind. Parashikime të ngjashme janë bërë edhe për Turqinë, një partner i rëndësishëm ekonomik për rajonin. Megjithatë nivelet e inflacionit kanë rënë, çmimet mbeten 20 përqind më të larta se në periudhën para COVID-19, veçanërisht janë prekur çmimet e ushqimeve, duke u rritur me 50 përqind. Banka Botërore gjithashtu vë në dukje disa “kokëdhimbje” të mundshme që mund të pengojnë performancën ekonomike, duke përfshirë rritjen e ulët ndër partnerët kryesorë tregtarë evropianë, politikën monetare shtrënguese, rritjen e barrës së borxhit dhe përshkallëzimin e tensioneve gjeopolitike rajonale dhe globale. Këta faktorë pritet të ngadalësojnë rritjen ekonomike dhe të ulin besimin e investitorëve dhe konsumatorëve.

Sipas Bankës Botërore, në Ballkanin Perëndimor mbetet ende hapësirë e konsiderueshme për përmirësim, veçanërisht në rritjen e dinamikës së biznesit, përfshirë hyrjen dhe daljen e bizneseve nga tregu. Mjedisi konkurrues nuk inkurajon mjaftueshëm inovacionin dhe as nuk mbështet në mënyrë efektive krijimin dhe përthithjen e njohurive dhe teknologjive të reja. Këto sfida përkeqësohen më tej nga intervenimi i tepruar e shtetit në ekonomi dhe dobësitë e dukshme në sistemet e arsimit dhe trajnimit, të cilat së bashku pengojnë përparimin në produktivitetin e fuqisë punëtore.

Një nga shqetësimet kryesore të Bankës Botërore është emigrimi i vazhdueshëm i të rinjve të arsimuar, një problem i qëndrueshëm në të gjitha vendet e rajonit. Zgjidhja sugjerohet në shfrytëzimin e rrjeteve të diasporës, maksimizimin e përfitimeve nga remitancat dhe zgjerimin e mundësive në tregun e punës vendor. Plani i ri i BE për rritjen ekonomike për Ballkanin Perëndimor synon të nxisë më tej rritjen ekonomike rajonale, i shoqëruar me reforma më të thella strukturore dhe demokratike.

● **Tabela 1.** Parashikimet e rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor

	BB		wiiw		FMN
	2024	2025	2024	2025	2025
Shqipëria	3.3	3.4	4.0	3.8	2.8
Bosnja e Hercegovina	2.8	3.2	2.6	2.9	3.8
Kosova	3.8	3.9	4.1	3.8	4.0
Mali i Zi	3.4	3.5	3.5	3.7	3.2
Maqedonia e Veriut	2.5	2.9	1.8	2.3	3.2
Serbia	3.8	4.2	3.7	3.7	3.5
Ballkani Perëndimor	3.2	3.5	3.4	3.4	-

Burimi: Banka Botërore: Ruajtja e momentumit të rritjes, Tetor 2024;

wiiw: Dobësitë e jashtme zbutin rritjen e fuqishme të drejtuar nga konsumatori, Tetor 2024; FMN, WEO, Prill 2025.

2.2 Sfidat e trendeve të rritjes

Pas një rritjeje më të ngadaltë në vitin 2023, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2024 dhe, sipas pritshmërive, në vitin 2025 është rikthyer në trendin para COVID-19, me një rritje rreth 4 përqind. Megjithatë kjo mbetet nën pritjet e planeve qeveritare, FMN dhe Banka Botërore e vlerësojnë më pozitivisht trendin e rritjes ekonomike të Kosovës krahasuar me vitin e kaluar, veçanërisht në aspektin e stabilitetit makroekonomik dhe performancës fiskale.

Megjithatë, në kundërshtim me pritjet, presionet inflacioniste në Kosovë janë në rritje. Inflacioni është rritur në pothuajse 3 përqind në mars, nga 2 përqind më parë, dhe rritja e fundit prej 16.1 përqind e çmimit të energjisë elektrike (maj 2025) pritjet të ndikojë negativisht më tej në situatën ekonomike dhe stabilitetin social.

Për më tepër, zgjerimi i deficitit të bilancit tregtar mbetet një shqetësim serioz. Rritja e importeve, e nxitur kryesisht nga konsumi i shtuar, ka tejkaluar rritjen e eksporteve, duke arritur në 70.3 përqind të PBB-së. Vlen të theksohet se mbulimi i importeve me eksportet e mallrave është përkeqësuar, duke rënë nga rreth 17.9 përqind në vitin 2022 në afërsisht 15 përqind në vitet 2023 dhe 2024. Këto çekuilibra kronike në

dinamikën tregtare paraqesin një sfidë të vazhdueshme për qëndrueshmërinë ekonomike të vendit.

Duke gjykuar nga perceptimet e drejtuesve të kompanive private në Kosovë lidhur me aktivitetet e tyre të biznesit, viti 2023 ishte më i mirë se viti 2024, pasi vetëm 28 përqind e kompanive raportuan rritje të shitjeve (55 përqind raportuan pa ndryshim dhe 13 përqind raportuan një rënie). Në vitin 2024, vetëm rreth një e treta e kompanive përjetuan rritje, ndërsa kjo përqindje u rrit në 54 përqind kur bëhet fjalë për pritshmëritë për vitin 2025.⁴ Nga kjo perspektivë, norma e parashikuar e rritjes së PBB-së prej 5.6 përqind në dokumentet e buxhetit për vitin 2025 mund të vihet në pikëpyetje për shkak të vështirësive në arritjen e rritjes reale të eksporteve (7 përqind) dhe investimeve private (6.1 përqind). Për më tepër, duke marrë parasysh tendencat e fundit, realizimi i rreth 800 milionë eurove në investime kapitale të planifikuara duket i mbivlerësuar.

Është gjithashtu e rëndësishme të merren parasysh vështirësitë e mundshme në konsolidimin e institucioneve qeveritare pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, të cilat mund të ndikojnë në pritjet e bizneseve dhe familjeve, si dhe në ciklin e biznesit, duke sfiduar më tej normën optimiste të rritjes ekonomike të parashikuar nga qeveria (Tabela 2).

4 Anketa e Riinvestit, shtator 2024

● **Tabela 2.** Rritja reale e PBB-së së Kosovës në % dhe parashikimet për vitin 2025

	2019	2020	2021	2022	2023	2024f	2025f
BERZH			10.7	4.3	3.3	4.0	4.0
IMF	4.8	-5.3	10.7	4.3	3.3	3.8	4.0
BB	4.8	-5.3	10.7	4.3	3.3	3.8	3.9
wiiw		-5.3	10.7	4.3	4.1	4.1	3.8
Qeveria e Kosovës (Projektligji për Buxhetin e vitit 2025)	4.8	-5.3	10.7	4.3	4.1	4.5	5.6

Burimi: Autorët, bazuar në të dhëna nga BERZH; FMN; BB; wiiw; Qeveria e Kosovës.

Një problem serioz vazhdon të jetë niveli i ulët i pjesëmarrjes në tregun e punës (Banka Botërore, 2024). Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, vetëm 37 përqind e popullsisë në moshë pune është e punësuar. Kjo do të thotë se nga çdo 100 individë në moshë pune (15-64 vjeç), vetëm 37 janë të punësuar. Ky fakt minon ndryshimet pozitive të pasqyruara në statistikat zyrtare që tregojnë një rënie të papunësisë në rreth 10.9 përqind. Duket se shumë individë në moshë pune dekurajohen të hyjnë në tregun e punës përmes regjistrimit në zyrat e punësimit për shkak të mungesës së instrumenteve dhe politikave aktive të tregut të punës (siç është ndihma financiare për të papunët) dhe rolit të papërfillshëm të zyrave të punësimit në ndërmjetësimin e vendimeve të punës. E gjithë kjo pasqyrohet në një ulje të normës statistikore të papunësisë. Kur i shtohet kësaj edhe trendi shqetësues i migrimit, veçanërisht ndër të rinjtë e papunë, bëhet e qartë se kjo ka ndikuar rëndë në saktësinë e matjeve dhe vlerësimeve statistikore të dinamikës së tregut të punës (më shumë detaje do të paraqiten në kapitullin 4).

Duke marrë parasysh kontekstin historik të karakterizuar nga një tranzicion i gjatë, i vështirë dhe specifik, me pasoja të rënda të luftës, deindustrializim brutal dhe një pozicion kolonial gjatë viteve 1990, ky nivel i rritjes ekonomike është i pamjaftueshëm. Ky realitet historik specifik krijoi një hendek të konsiderueshëm në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, veçanërisht krahasuar me BE-në. Si pasojë, rritja ekonomike gjatë këtyre dy dekadave e gjysmë është ndërtuar mbi një situatë kritike dhe të diktuar nga emergjencat, e cila nuk arriti të vendosë parakushtet për kapërcimin e çekuilibrave makroekonomikë, veçanërisht papunësinë dhe deficitin tregtar. Ky model, i bazuar në faktorë të jashtëm – remitanca, ndihmë teknike dhe financiare të huaj dhe kredi – ka humbur pothuajse plotësisht fuqinë e tij transformuese dhe potencialin për të gjeneruar rritjen që i nevojitet Kosovës.⁵ Ai ka dështuar të përmirësojë konvergimin e tij me vendet e BE-27 dhe të adresojë çekuilibrat makroekonomikë në konfigurimin e përgjithshëm ekonomik.

5 Ai ka ruajtur një përbërje të papërshtatshme sektoriale të PBB-së, duke penguar ndryshimet e nevojshme gjatë periudhës 2010–2023 (Aneks A1)

Modeli ekzistues i rritjes ekonomike të Kosovës ka qenë kryesisht i drejtuar nga konsumi për gati 25 vjet. Ky trend është i dukshëm edhe në vitet e fundit, ku konsumi mbetet kontribuuesi kryesor i rritjes ekonomike. Gjatë dy viteve të fundit, me norma të rritjes ekonomike prej 3.3 përqind dhe 3.8 përqind, kontributi i konsumit ka qenë përkatësisht 3.9 dhe 4.6 pikë përqindje, ndërsa investimet kanë kontribuar me 1 dhe 1.7 pikë përqindje (Tabela 3). Nëse supozojmë se importet dhe eksportet në Kosovë do të ishin të balancuara (pra, eksportet neto ishin të barabarta me zero), rritja ekonomike do të kishte arritur në 4.9 përqind (3.9 + 1) në vitin 2023 dhe rreth 6.3 përqind (4.6 + 1.7) në vitin 2024. Megjithatë, deficitit tregtar negativ e ul normën e rritjes. Kjo do të thotë se për të mbështetur këtë konsum, një pjesë e konsiderueshme e mallrave dhe shërbimeve është importuar, duke bërë që rritja të bjerë nga potenciali prej 4.9 përqind në 3.3 përqind në vitin 2023 dhe nga 6.3 përqind në 3.8 përqind në vitin 2024. Kjo tregon se Kosova ka kontribut të pamjaftueshëm nga investimet dhe eksportet për të gjeneruar një rritje më të lartë ekonomike. Në këtë model, rritja e konsumit nxit importin e lartë të mallrave të konsumit, duke ulur kështu normën e rritjes ekonomike dhe duke krijuar një cikël të paqëndrueshëm në ekonomi. Këto mbeten problemet kryesore që duhen adresuar përmes politikave sistematike dhe gjithëpërfshirëse, si dhe masave të tjera.

● **Tabela 3.** Kontribuuesit e rritjes ekonomike ne Kosove 2023 dhe 2024

Përshkrimi	2023	2024
Rritja reale ekonomike %	3.3	3.8
Kontributi në rritje		
Konsumi	3.9	4.6
Investimet	1.0	1.7
Eksporti neto (Eksporti -Importi)	-1.6	-2.5

Autorët, bazuar në të dhënat e Bankës Botërore (2024)

6 Aneks A2
7 Aneks A3
8 Aneks A4

2.3 Tregtia e jashtme dhe sektori i jashtëm

Si pasojë, paralelisht me rritjen ekonomike, bilanci tregtar është përkeqësuar, me deficitin që është rritur me 65 përqind që nga viti 2019, duke arritur në 31.4 përqind të PBB-së. Veçanërisht shqetësues është fakti se deficitit i bilancit tregtar të mallrave është rritur me 74.4 përqind gjatë të njëjtës periudhë.⁶ Megjithatë, është evidentuar një diversifikim i eksporteve për sa i përket produkteve që kalojnë vlerën prej një milion euro në vit, nga 32 produkte në vitin 2015 në 114 produkte në vitin 2023.⁷ Ka një trend pozitiv në eksportet e shërbimeve, ku bilanci pozitiv është dyfishuar pothuajse gjatë periudhës 2019 – 2024.⁸ Ky trend pozitiv ka mangësitë e tij sa i përket strukturës së eksporteve të shërbimeve, pasi rreth tre të katërtat e vlerës së tyre lidhen me turizmin e diasporës, përkatësisht me udhëtimet dhe konsumin e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë. Kontribuesi i dytë më i madh janë shërbimet e teknologjisë së informacionit, dhe telekomunikacionit. Ky është një tregues pozitiv për potencialet e këtij sektori. Sipas Barometrit më të fundit të TIK-ut, 39 përqind e këtyre kompanive përqendrohen ekskluzivisht në tregjet ndërkombëtare (STIKK, 2022). Ndërkohë, të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës tregojnë se Kosova eksporto-i rreth 60 milionë euro në shërbime TIK drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 44.4 milionë euro drejt Zvicrës dhe 38.4 milionë euro drejt Gjermanisë vitin e kaluar.

● **Tabela 4.** Bilanci i tregtisë së jashtme (milionë Euro)

	PBB	Mallra	Shërbime	Totali	Deficiti/PBB (%)
2019	6.989	-2,840	926	-1,914	-27%
2020	6,679	-2,573	392	-2,182	-33%
2021	7,499	-3,576	1,035	-2,532	-34%
2022	8,299	-4287	1,276	-2,911	-35%
2023	9,680	-4,589	1,629	-2.962	-31%
2024	10,035	-4926	1,791	-3,153	-31%

Autorët, bazuar në BQK, Buletini Statistikor Mujor, 2025.

Duke parë bilancin e pagesave, mund të vërehet se remitancat gjatë pesë viteve të fundit kanë ruajtur pjesën e tyre në PBB ndërmjet 13.5-14.5 përqind, duke demonstruar rëndësinë dhe ndikimin e tyre në strukturën e të ardhurave të ekonomive familjare dhe në nxitjen e konsumit, veçanërisht gjatë sezonit veror.

Investimet e Jashtme Direkte (IJD) kanë shënuar një rritje në vëllimin dhe pjesën e tyre në PBB gjatë dy viteve të fundit. Megjithatë, ato kanë origjinë kryesisht nga diaspora dhe dominohen nga sektori i pasurive të paluajtshme. Kjo nuk përkthehet në mënyrë adekuate në zhvillim ekonomik afatgjatë për shkak të pjesës së lartë të inputeve të importuara dhe, rrjedhimisht, efektit më të ulët multipëlikues. Sektorë

të tjerë me pjesë të konsiderueshme përfshijnë aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (16 përqind) dhe sektorin e energjisë (8 përqind). Tërheqja e investimeve në sektorin e prodhimit, si sektori kryesor për zhvillimin e potencialit të eksportit dhe produkteve e shërbimeve me vlerë të shtuar të lartë, është shumë e ultë dhe mbetet një sfidë serioze

Pavarësisht rritjes së investimeve të jashtme direkte në Kosovë në vitin 2024, përqësimi i bilancit të llogarisë financiare mund të lidhet me ndikimin e investimeve në portofol dhe investimeve të tjera, të cilat kanë kontribuar në daljen neto të kapitalit. Si pasojë, këto trende në sektorin e jashtëm pasqyrojnë rritjen e deficitit në bilancin e pagesave, i cili mbetet një shqetësim tjetër.

Tabela 5. Statistikat e tregtisë së jashtme ndër vite

	Dërgesat e migrantëve		Investimet e jashtme direkte		Llogaria rrjedhëse		Bilanci nga llogaria financiare		Bilanci i pagesave	
	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)
2019	851.5	12.1	254.6	3.6	-408.3	-5.8	-161.1	-2.3	-399.5	-5.7
2020	980	14.5	345.7	5.1	-454.7	-6.7	-562.1	-8.3	-472.2	-7.0
2021	1153.4	14.5	420.7	5.3	-632.5	-7.9	-365.0	-4.6	-694.7	-8.7
2022	1222.8	13.7	732.0	8.2	-878.7	-9.9	-661.6	-7.4	-917.1	-10.3
2023	1335.8	13.8	840.1	8.7	-729.4	-7.5	-415.5	-4.3	-666.5	-6.9
2023 (Jan - Qer)	627.4	14.9	371.1	8.8	-538	-12.7	-255.7	-6.1	-491.6	-11.6
2024 (Jan - Qer)	630.1	13.9	419.1	9.3	-691.8	-15.3	-496.6	-11.0	-667.9	-14.8

Burimi: BQK dhe ASK

2.4 Sektori financiar

Sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të ndjekë trende pozitive zhvillimi këtë vit në aspektet e qëndrueshmërisë, rezistencës dhe rritjes. Ai mbetet mirë i kapitalizuar, fit-imprurës dhe likuid. Treguesit kryesorë të kthimit, si ROA (Kthimi mbi Aktivet) dhe ROE (Kthimi mbi Kapitalin), në sektorin bankar qëndrojnë përkatësisht në 2.6 përqind dhe 19.2 përqind, duke reflektuar kthime të qëndrueshme dhe të forta ndër vite. Likuiditeti është rreth 31 përqind (aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra), ndërsa raporti kredi-depozitë është 84.7 përqind, kreditë me probleme janë vetëm 2 përqind dhe kapitalizimi është rreth 15.5 përqind, duke treguar një performancë të fortë brenda sektorit bankar. Rritja e kredive në ekonomi vazhdon të ndjekë një trend në rritje, me kreditë që rriten me 15 përqind në vit. Kreditë për amvisëritë kanë shënuar një rritje më të madhe krahasuar me kreditë për korporata, me norma rritjeje përkatësisht prej 20 përqind dhe 11 përqind. Depozitat gjithashtu janë rritur me 11 përqind, megjithëse kjo është më e ngadaltë se vitin e kaluar. Në aspektin e strukturës, kreditë për amvisëritë përbëjnë tani 40 përqind të totalit, duke reflektuar një rritje prej dy pikë përqindjeje. Kreditë për korporatat, megjithatë,

ruajnë një strukturë të ngjashme, duke pasqyruar përbërjen e ekonomisë. Për shembull, kreditë në bujqësi përbëjnë 2 përqind, ndërsa industria, energjia dhe ndërtimi përbëjnë 34 përqind, dhe shërbimet dominojnë me 64 përqind, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm. Nuk ka kontribut të veçantë të kredimit të investime në sektorët që tregojnë potencial për eksport. Sa i përket maturitetit, struktura e kredive ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit: kreditë me maturitet deri në një vit përbëjnë 10 përqind, kreditë me maturitet 1-5 vjet përbëjnë 35 përqind dhe kreditë me maturitet mbi 5 vjet përbëjnë 55 përqind. Kredia për sektorin privat si përqindje e PBB-së, e cila arrin gati 50 përqind, është mbi mesataren për Ballkanin Perëndimor, me Kosovën që performon më mirë në krahasim me shumicën e vendeve të rajonit. Pas një periudhe të rritjes së normave të interesit në nivel global, të nxitura nga inflacioni dhe kushtet shtrënguese monetare, këto trende nuk duket se janë reflektuar plotësisht në sektorin bankar në Kosovë. Normat e interesit për kreditë kanë shënuar një rënie të lehtë, ndërsa normat e interesit për depozitat janë rritur, duke ngushtuar marzhin e interesit nga 4.1 pikë përqindjeje në 3.2 pikë përqindjeje këtë vit.

2.5 Sektori qeveritar dhe politikat e buxhetit

Politika fiskale dhe buxhetore në rastin e Kosovës është instrumenti kryesor i qeverisë për politikat e saj ekonomike, me qëllim ruajtjen e stabilitetit fiskal dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025 tregojnë se, ashtu si në periudhat e mëparshme, politikat kanë rezultuar në stabilitet makrofiskal, por ato janë shoqëruar gjithashtu me një strukturë të pafavorshme në aspektin e shpenzimeve për infrastrukturë dhe mekanizmeve që përshpejtojnë rritjen ekonomike, të shoqëruara me financim të pamjaftueshëm në arsim, shëndetësi, kërkim shkencor, inovacion dhe një mosefikasitet kritik në zbatimin e projekteve që lidhen me investimet kapitale. TVSH-ja, e cila ende mbledhet rreth 2/3 në kufi, dhe akcizat mbeten burimi kryesor i të ardhurave buxhetore (74 përqind). Tatimet e drejtpërdrejta mbeten modeste, duke përfaqësuar rreth 17 përqind të totalit të të ardhurave, që pritet të arrijnë 356 milionë euro këtë vit dhe të rriten nga 292 milionë euro në vitin 2024, me rritjen më të madhe që vjen nga tarifat koncesionare për shkak të rritjes së numrit të pasagjerëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Megjithëse normat tatimore janë relativisht të ulëta, ekziston gjithashtu një bazë e pamjaftueshme e mbledhjes së taksave të brendshme. Për më tepër, Kosova është i vetmi vend në rajon ku dividendët nuk taten fare. Fitimet kapitale, veçanërisht nga transaksionet e pasurive të paluajtshme, janë pothuajse të pa tatuara për shkak të kufizimeve administrative (Banka Botërore, 2023).⁹

Shpenzimet totale për vitin 2025 parashikohen të arrijnë në 3.6 miliardë euro, një rritje prej 8.8 përqind krahasuar me vitin 2024, duke rritur pjesën e tyre në PBB në 32.7 përqind. Shpenzimet aktuale për paga, subvencione dhe mallra janë parashikuar të përbëjnë 72 përqind të totalit të shpenzimeve. Parashikimet për mallrat kapitale mbeten në të njëjtin nivel si në vitin 2024, rreth 26 përqind e shpenzimeve. Megjithatë, shpenzimet reale për mallrat kapitale gjatë viteve të fundit kanë qenë vetëm në nivelin 60-68 përqind të parashikimeve, duke reflektuar mangësi në përgatitjen e projekteve, menaxhimin e projekteve dhe prokurimin.

Ndarja e fondeve nuk ndjek në mënyrë adekuate prioritetet e shpallura kombëtare, veçanërisht kur bëhet fjalë për fondet e dedikuara për kujdesin shëndetësor, arsimin, kërkimin shkencor dhe inovacionin. Ky nivel i financimit për kujdesin shëndetësor është dukshëm më i ulët jo vetëm krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe OECD-së, por edhe në krahasim me vendet e rajonit, përveç Shqipërisë (rreth 3 përqind e PBB-së). Shpenzimet e qeverisë për kujdesin shëndetësor në Bosnje dhe Hercegovinë arrijnë në 6.5 përqind të PBB-së, në Mal të Zi 6.5 përqind, në Serbi 6.3 përqind dhe në Maqedoninë e Veriut 4.7 përqind (Instituti Riinvest, 2024). Shpenzimet për arsimin dhe shkencën në vitin 2025, duke përfshirë grantet për komunat, pritet të arrijnë në 388 milionë euro, ose 3.5 përqind të PBB-së (2025), që është nën mesataren e BE-së prej 4.7 përqind.

Fondet e dedikuara për politikat e tregut të punës (33 milionë euro) dhe mbështetjen për bizneset dhe industrinë (39 milionë euro) janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat urgjente. E njëjta gjë vlen edhe për fondet e dedikuara për mjedisin (60 milionë euro) dhe energjinë (59 milionë euro), të cilat përbëjnë vetëm rreth 4 përqind të buxhetit sektorial.

Në përgjithësi, struktura atipike e shpenzimeve buxhetore, e cila është më shumë e orientuar drejt shpenzimeve aktuale sesa investimeve, ngadalëson krijimin e vendeve të punës, pengon rritjen e produktivitetit dhe kufizon potencialin për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Struktura e buxhetit është qartësisht e anuar drejt transfereve dhe subvencioneve, në dëm të investimeve kapitale dhe pagave.

E lidhur me këtë është edhe kapërcimi i dobësive dhe mosefikasitetin e theksuar në zbatimin e Programit të Investimeve Publike (PIP). Siç analizohet më tej, politikat buxhetore kanë dështuar prej kohësh të arrijnë këtë qëllim. Në një nga vlerësimet e saj paraprake, FMN thekson: "Mangësitë në menaxhimin e investimeve publike kanë një ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e investimeve dhe përkeqësojnë situatën" (FMN, 2023). Sipas FMN-së, kjo kërkon një përmirësim të strukturës dhe kapacitetit përthithës të investimeve publike, duke kapërcyer dobësitë e ndryshme në menaxhimin e investimeve publike që lidhen me shpronësimin e tokës, prokurimin dhe zbatimin e kontratave. Mangësitë në zbatimin

⁹ Pjesa e të ardhurave buxhetore ndaj PBB-së në Kosovë arriti në 29.9 përqind, ndërsa shpenzimet në 30.1 përqind, pak më të larta se në Shqipëri, por shumë më të ulëta se në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, ku të dyja këto kategori janë mbi 40 përqind (Banka Botërore, Raporti i Rregullt i Pranverës 2025).

e kontratave veçanërisht rrisin kostot e investimeve dhe zvogëlojnë ndjeshëm efektet e pritura të këtyre projekteve në fazën e operimit. Për më tepër, Banka Botërore konstaton se, në përgjithësi, vendimet për shpenzimet publike nuk janë në përputhje me prioritetet strategjike dhe “procesi buxhetor mbetet i shkëputur nga performanca” (Banka Botërore, 2023). Një tjetër problem është efikasiteti i ulët dhe efektet e pafavorshme të transfereve dhe subvencioneve, përfshirë ato në bujqësi dhe ndërmarrje publike, ku pothuajse mungon një standard i nevojshëm për vlerësimin e projekteve në fazën e miratimit të tyre, kontrollin dhe vlerësimin ex-post të efekteve të tyre.

2.6 Borxhi publik

Portofoli i përgjithshëm i borxhit publik të Kosovës (rreth 17 përqind e PBB-së) mbetet në nivele të qëndrueshme dhe brenda rregullave fiskale dhe Ligjit për Borxhin Publik dhe Garancitë Shtetërore, i cili përcakton që borxhi publik nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të PBB-së. Borxhi i brendshëm përbëhet kryesisht nga emetimi i obligacioneve të thesarit. Sipas parashikimeve të qeverisë, deri në fund të vitit 2024, ky komponent i borxhit publik pritet të arrijë në 1.07 miliardë euro, ose 53.7 përqind të borxhit total. Ndërsa është pozitive që më shumë se gjysma e borxhit total është i brendshëm, shqetësues është fakti se ky borxh po përdoret për të mbuluar deficitin buxhetor të lidhur me blerjen e mallrave dhe shërbimeve, si dhe transferet (ZKA, 2023), në vend që të financojë investimet kapitale.

Borxhi i jashtëm në fund të vitit 2024 pritet të arrijë rreth 921 milionë euro, duke treguar një rritje prej 33 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Ky borxh i jashtëm i detyrohet organizatave ndërkombëtare financiare, kryesisht Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (Banka Botërore) me 36 përqind, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BER-ZH) me 13 përqind, Bashkimit Evropian (BE) me 14 përqind dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) me 11 përqind. Borxhi i jashtëm është i dedikuar për financimin e projekteve në sektorë si arsimi, bujqësia, regjistri i tokës, energjia, shëndetësia, trajtimi i ujërave të zeza, ngrohja qendrore, rehabilitimi i rrugëve dhe hekurudhave (MFPT, 2023). Në vitin 2023, Kuvendi ratifikoi tetë (8) marrëveshje kredie/financiare për financimin e projekteve në sektorët e mjedisit, energjisë, transportit, dixhitalizimit të administratës publike, si dhe reformave të financave publike dhe rritjes ekonomike. Megjithatë, situata lidhur me dinamikën e zbatimit të projekteve të lidhura me borxhet e kontraktuara është shqetësuese. Sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA, 2023), vonesat në marrëveshjet e kredisë dhe tërheqja e ngadaltë e fondeve të disponueshme janë një pengesë e zakonshme ndër vite. Kjo reflekton planifikim të dobët, procesin e shpronësimit dhe, në përgjithësi, mangësi në kapacitetet e qeverisë për të shfrytëzuar në mënyrë efektive dhe në kohë fondet e huazuara.

3. INVESTIMET – DINAMIKA, STRUKTURA DHE EFIKASITETI

Dinamika dhe cilësia e rritjes ekonomike, si dhe zhvillimi i përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror, përcaktohen kryesisht nga volumi dhe cilësia e aktiviteteve investuese. Volumi i referohet thellësisë ose peshës së investimeve bruto në PBB (investimet si pjesë e PBB-së), të shprehura si përqindje. Vendet me një përqindje më të lartë të investimeve në raport me PBB-në synojnë një normë më të lartë të rritjes dhe zakonisht janë në një fazë më të ulët të zhvillimit. Megjithatë, rritja ekonomike nuk varet vetëm nga volumi i investimeve, por edhe nga cilësia e tyre — pra, efikasiteti i investimeve dhe kontributi i tyre marxhinal në rritjen e PBB-së.

Efikasiteti varet nga cilësia e procesit përgatitor për vendimet e investimeve, vlerësimi i kostos dhe përfitimeve, zbatimi i projekteve të miratuara dhe shfrytëzimi i suksesshëm gjatë

periudhës së tyre operacionale. Tabela 13. Norma e Investimeve në Kosovë dhe në vendet e rajonit.

Kosova ka pjesën më të lartë mesatare të Formimit të Bruto Kapitalit (33.6 përqind) në Ballkanin Perëndimor për periudhën 2014–2023. Megjithatë, kjo pjesëmarrje e lartë nuk është transformuar r në norma të larta të rritjes ekonomike, duke ngritur pyetje serioze mbi efikasitetin e këtyre investimeve dhe ndikimin e tyre në produktivitet.¹⁰

Investimet totale përfshijnë investimet e sektorit privat, investimet e qeverisë dhe ndërmarrjeve publike, si dhe investimet e huaja, përfshirë kontributet nga diaspora. Një përmblendje e këtyre investimeve për vitin 2023 është paraqitur në Tabela 6.

● **Tabela 6.** Investimet në Kosovë në vitin 2023 (në miliona Euro)

	A		B	
	2023	Proporcioni (%)	2023	Proporcioni (%)
1. Investimet qeveritare	554	24	554	18
2. Investimet e ndërmarrjeve publike	85	4	85	3
3. Investimet e sektorit privat	817*	36	1600**	52
4. IJD	840	37	840	27
5. Totali dhe struktura në %	2296	100	3079	100

Burimi: 1 – Qeveria e Kosovës; 2 – Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike; 3 – *ATK, **Anketa e Institutit Riinvest; 4 – BQK.

10 Maqedonia e Veriut (32.0 përqind) gjithashtu ka nivel të lartë të investimeve, ndërsa Mali i Zi (27.6 përqind) shfaq variacione të theksuara, kryesisht për shkak të projekteve të mëdha infrastrukturore. Bosnja dhe Hercegovina (24.4 përqind) dhe Shqipëria (23.6 përqind) mbajnë nivele relativisht të qëndrueshme, ndërsa Serbia (22.0 përqind) ka nivelin më të ulët të investimeve si pjesë e PBB-së.


Sipas këtyre të dhënave, niveli i investimeve në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 2.3 miliardë euro. Ky llogaritje bazohet në të dhënat administrative të raportuara nga institucionet përkatëse. Nëse, për nivelin e investimeve të sektorit privat, përdorim të dhëna nga Instituti Riinvest të ekstrapoluara për të përfshirë të gjithë popullsinë, niveli i investimeve arrin në rreth 3.1 miliardë euro.

Megjithëse ky shifër është më afër nivelit të vlerësuar të investimeve bruto në Kosovë, siç është llogaritur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), FMN, Banka Botërore, Banka Qendrore dhe Qeveria, ende ekziston një mosmarrëveshje. Kjo thekson rëndësinë e përmirësimit të informacionit statistikor, veçanërisht lidhur me investimet e sektorit privat.

3.1 Efiçienca e investimeve dhe rritja ekonomike

Gjatë dekadës së fundit, pjesëmarrja e Formimi të Bruto Kapitalit Fiks (ang. Gross Fixed Capital Formation) (GFCF) në PVB-të e Kosovës ka shfaqur një rritje graduale, duke ritur nga 28 përqind (në vitin 2014) në 33 përqind (në vitin 2021) përpara se të stabilizohet rreth 31 për qind në vitet vijuese (Figura 1). Ky trend tregon se Kosova ka ndarë një pjesë gjithnjë e më të madhe të burimeve të saj ekonomike për investime në kapitalin fiks, të cilat janë thelbësore për rritjen ekonomike afatgjatë dhe zhvillimin e infrastrukturës.

● **Figura 1.** Formimi i bruto kapitalit fiks në raport me PBB-në në Kosovë



Burimi: ASK, 2024


Megjithatë, pavarësisht rritjes së pjesës së GFCF-së, norma e përgjithshme e rritjes ekonomike të Kosovës ka mbetur relativisht e ulët, me një mesatare prej 4 përqind. Kjo sugjeron se, ndonëse më shumë burime po drejtohen drejt investimeve, produktiviteti ose efikasiteti i këtyre investimeve nuk është përmirësuar në mënyrë proporcionale. Kjo tregon se ka sfida strukturore ose joefikasitet në shndërrimin e investimeve në rritje më të shpejtë.

Për të vlerësuar produktivitetin e kapitalit në Kosovë, ne kemi përdorur raportin inkremental të kapitalit dhe outputit (ang. Incremental Capital-Output Ratio) (ICOR), i cili lidh nivelet e investimeve me ndryshimet në PVB për periudhën 2015 deri në 2023. Qëllimi është të kapim ndryshimet afatmesme në ICOR-it dhe të shqyrtojmë marrëdhënien midis nivelit të kapitalit dhe rritjes së prodhimit. Në këtë kontekst, ICOR ndikohet nga disa faktorë, përfshirë ritmin e përparimit teknologjik, zhvillimin e aftësive profesionale dhe menaxheriale dhe cilësinë e strukturave organizative brenda ekonomisë. Ndryshe nga një fokus i ngushtë mbi investimet e reja, ICOR përveç se konsideron të ardhurat e gjeneruara nga investimet e reja, poashtu konsideron edhe produktivitetin e aseteve ekzistuese. Kjo për faktin se ndryshimi në PBB (emëruesi në këtë rast), reflekton produktivitetin e gjithë stokut të kapitalit. Duke qenë se asetet ekzistuese janë shpesh më të mëdha sesa kapitali i shtuar çdo vit, ICOR reflekton efikasitetin e të gjithë stokut të kapitalit dhe jo vetëm të investimeve të fundit. Për shembull, një rënie e shfrytëzimit të kapaciteteve, mund të çojë në një rritje të ICOR-it, edhe nëse investimet e reja janë produktive. Kjo do të thotë që ICOR në Kosovë mund të rritet jo për shkak të mungesës së efikasitetit në investimet e reja, por për shkak të sfidave në shfrytëzimin e plotë të aseteve ekzistuese.

Në fakt, të dhënat nga anketa, e realizuar për qëllim të këtij studimi, evidenton se shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve nga bizneset është rreth 61 përqind. Kjo nënkupton që shumë kompani nuk e përdorin të gjithë potencialin e kapaciteteve të tyre ekzistuese, gjë që çon në uljen e efikasitetit të investimeve dhe, rrjedhimisht, në një ICOR më të lartë, që do të thotë se përdoret me shumë kapital fiks për të arritur një normë të caktuar të outputit, përkatësisht GDP. Shfrytëzimi i ulët i kapaciteteve mund të jetë rezultat i sfidave të kërkesës së pamjaftueshme, mungesës së burimeve të kualifikuara ose kushteve të pafavorshme të tregut, duke sugjeruar se përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve mund të kontribuojë në uljen e ICOR-it dhe rritjen e efikasitetit të kapitalit në vend.

Për të pasur një pamje më të mirë të ICOR-it të Kosovës, i njëjti është vendosur në një perspektivë rajonale duke e krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Figura 8). Vlerat e ICOR-it evidentojnë dallime të mëdha në efikasitetin e kapitalit në rajon. Kosova veçohet me ICOR-in më të lartë prej 4.62, që tregon se ajo kërkon investime kapitali ndjeshëm më të mëdha për të gjeneruar rritje ekonomike në krahasim me fqinjët e saj. Në anën tjetër, Serbia ka ICOR-in më të ulët prej 2.21, që sugjeron një efikasitet relativisht të lartë në shndërrimin e investimeve në prodhim ekonomik. Shqipëria dhe Mali i Zi gjithashtu tregojnë një efikasitet mesatar, me vlera të ICOR-it prej 2.50 dhe 2.96, përkatësisht. Bosnja dhe Hercegovina (3.36) dhe Maqedonia e Veriut (3.92) kanë ICOR më të larta, por mbeten më efikase se Kosova.

● **Figura 2.** ICOR në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Autorët në bazë të të dhënave të publikuara nga EUROSTAT, 2024

Për më tepër, struktura teknike e investimeve të bizneseve në Kosovë gjatë periudhës 2023 deri në 2025 nga rezultatet e anketës ilustron disa arsye që sqarojnë ICOR-in e lartë.¹¹ Në vitin 2023, një pjesë e madhe e investimeve është përqendruar në asete më pak produktive, me 58.4 përqind të alokuara për ndërtesa të reja dhe 29.7 përqind për tokë, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël është drejtuar drejt makinerive dhe pajisjeve (4 për qind) dhe kërkimit dhe zhvillimit (0.16 për qind). Kjo shpërndarje tregon se kapitali është drejtuar drejt aseteve që, ndonëse të rëndësishme për zgjerimin e biznesit, nuk rrisin menjëherë produktivitetin, çka çon në një ICOR më të lartë. Këtu, qeveria qendrore dhe autoritetet lokale mund të bëjnë pjesën e detyrave të tyre për të lehtësuar infrastrukturën (energji, ujë, rrugë, telekomunikacion) dhe lokacionin e bizneseve për të reduktuar ngarkesën aktuale të sektorit privat, i cili është i detyruar të investojë shumë për këto qëllime.

Të dhënat nga anketa janë tregojnë pritshmëri premtuese nga respondentët për investime me një orientim drejt aseteve më produktive në vitet në vijim. Saktësisht, pritet që pjesa e investimeve në makineri dhe pajisje të rritet ndjeshëm, nga 4 përqind në vitin 2023 në 22.6 përqind deri në vitin 2025. Nëse ky fokus në asete më produktive realizohet, ai mund të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të kapitalit dhe rritjen e përgjithshme ekonomike në Kosovë.

Struktura teknike e investimeve gjithashtu zbulon se shpenzimet për kërkim dhe zhvillim mbeten shumë të ulëta, me vetëm 0.16 për qind të alokuara në 2023 dhe një rritje të lehtë në 0.38 për qind të planifikuar për 2025. Megjithatë, ka një shenjë pozitive me investimet në kërkim dhe zhvillim që pritet të rriten gjë që sugjeron një vetëdijësim në rritje të rëndësisë së kërkimit dhe zhvillimit për të nxitur

11 Aneks A5.

inovacionin dhe konkurrueshmërinë afatgjatë. Nëse ky trend vazhdon, edhe rritje të vogla në kërkim dhe zhvillim mund të kontribuojnë në përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e ICOR-it në të ardhmen, pasi inovacioni mund të nxisë një përdorim më efikas të kapitalit në sektorë të ndryshëm.

Në përgjithësi, megjithëse ICOR është një tregues informues, interpretimi i tij për Kosovën kërkon edhe analizë të përbërjes sektoriale, gjë që ndikon në kuptimin më të mirë të produktivitetit të kapitalit. Duke u bazuar në të dhënat e anketës dhe të dhënat e ATK-së për shpërndarjen sektoriale të investimeve, dhe të dhënat e ASK-së në lidhje me kontributin e secilit sektor në PBB, ne kemi kalkuluar ICOR-in për secilin sektor në bazë të klasifikimit NACE (një shifror).

Të dhënat sugjerojnë se në Kosovë ka dallime domethënëse në nivelin e ICOR-it nëpër sektorë të ndryshëm. Sektorët me ICOR të ulët dhe raporte të ulëta të investimeve ndaj qarkullimit, si sektori financiar dhe arsimi, janë shumë efikasë, duke kërkuar investime minimale për të gjeneruar prodhim dhe të ardhura të konsiderueshme. Në anën tjetër, sektorët me ICOR të larta, si ndërtimtaria, dhe energjia kërkojnë investime të mëdha kapitale, të cilat nuk përkthehen në mënyrë efikase e të shpejta në prodhim, për shkak të kostove të larta të infrastrukturës, kohës së kthimit, dhe sfidave operacionale. Sektorët me ICOR të moderuar, si prodhimi dhe akomodimi, kërkojnë diversifikim të investimeve dhe shfrytëzim më të lartë të kapaciteteve.

Të dhënat sektoriale mbi investimet, kontributin në PBB dhe qarkullimin sipas sektorëve në Kosovë tregojnë një ekonomi të mbështetur kryesisht në tregtinë me shumicë dhe pakicë dhe ndërtimtarinë.¹² Tregtia përfaqëson 31.23 përqind të investimeve, 14 përqind të PVB-së dhe 53 përqind të qarkullimit, duke reflektuar një treg të fuqishëm konsumator, por krijon një varësi të rrezikshme nga kërkesa e konsumatorit. Ndërtimtaria përbën 17.13 përqind të investimeve, por kontribuon vetëm 8 përqind në PBB, për shkak të natyrës së saj që kërkon më shumë kapital dhe ndikimit të saj të vonuar ekonomik. Kjo varësi nga tregtia dhe ndërtimtaria e bën ekonominë të ndjeshme ndaj goditjeve sektoriale dhe kufizon diversifikimin afatgjatë. Ndërkohë, industria përpunuese, e cila përfaqëson 15.43 përqind të investimeve, 13 përqind të PBB-së dhe 14 përqind të qarkullimit, është thelbësore për të adresuar varësinë e disbalancet strukturore të ekonomisë së Kosovës. Kjo mund të arrihet nëse shfrytëzimi i kapaciteteve rritet dhe struktura e investimeve drejtohet drejt elementeve më efektive si makineritë dhe pajisjet, kërkimi dhe zhvillimi dhe trajnimet. Përqendrimi në këto fusha do të ndihmonte industrinë përpunuese të rrisë produktivitetin dhe të ulë varësinë e lartë të Kosovës nga importet, duke kontribuar në një ekonomi më të qëndrueshme dhe konkurruese.

12 Aneks A6.

4. KAPITALI NJERËZOR DHE MIGRIMI

4.1 Dinamikat në tregun e punës në Kosovë

Tregu i punës në Kosovë vazhdon të përballët me sfida strukturore të rëndësishme, përfshirë nivele të ulëta të

pjesëmarrjes, papunësi të lartë—veçanërisht mes të rinjve dhe grave—dhe një mangësi të dukshme të aftësive (Tabela 1). Këto probleme përkeqësohen më tej nga emigrimi i konsiderueshëm, i cili shteron fuqinë punëtore vendase dhe dëmton zhvillimin ekonomik.

Tabela 6. Treguesit kyç të tregut të punës (% e popullsisë në moshë pune)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (15-64 vjeç)	38.7	42.8	40.9	40.5	38.3	39.3	38.6	40.7
Shkalla e popullsisë joaktive ekonomikisht si përqindje e popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç)	61.3	57.2	59.1	59.5	61.7	60.7	61.4	59.3
Raporti i punësimit ndaj popullsisë - shkalla e punësimit (15-64 vjeç)	28.0	29.8	28.8	30.1	28.4	31.1	33.8	36.3
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	27.5	30.5	29.6	25.7	25.9	20.7	12.6	10.9
Shkalla e forcës punëtore të të rinjve (mosha 15-24 vjeç)	21.2	23.7	22.4	25.9	22.4	21.6	19.6	22.1
Raporti i punësimit ndaj popullsisë për të rinjtë - shkalla e punësimit të të rinjve (15-24 vjeç)	10.1	11.2	10.0	13.1	11.4	13.4	15.4	18.3
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	52.4	52.7	55.4	49.4	49.1	38.0	21.4	17.3
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullatën e të rinjve (15-24 vjeç)	30.1	27.4	30.1	32.7	33.6	32.1	33.0	33.4
Pjesëmarrja e punësimit jo të qëndrueshëm në punësimin total (15-64 vjeç)	22.9	23.1	19.6	18.8	17.0	12.7	13.3	15.3

Agjencia e Statistikave të Kosovës: Treguesit e Tregut të Punës

Në vitin 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës për individët e moshës 15–64 vjeç ishte 40.7 përqind, duke reflektuar një përmirësim të vogël nga 38.6 përqind në vitin 2022 (ASK, 2025). Megjithatë, ky tregues mbetet ndjeshëm më i ulët se mesatarja e vërejtur në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe në Bashkimin Evropian, ku shkallët e pjesëmarrjes janë përkatësisht rreth 69 përqind dhe 75 përqind (FMN, 2025).

